VENDIM
Nr. 940, datë 28.12.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.884, DATË 16.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPËRBLIMIN DHE KOMPENSIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR FESTAT E FUNDVITIT, 2016"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 17, të ligjit nr.147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr.884, datë 16.12.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:

"Efektet financiare të përballohen në masën 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe në masën 122 000 000 (njëqind e njëzet e dy milionë) lekë nga fondi i kontingjencës, të miratuar për vitin 2016. Pjesa tjetër të përballohet nga buxheti i vitit 2016, zëri "Ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë", miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama